



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.193

dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 200 datë 17.12.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar	8519
Ligj nr.10 201 datë 17.12.2009	Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore	8524
Ligj nr.10 202 datë 17.12.2009	Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore	8538

LIGJ
Nr.10 200, datë 17.12.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10 033,
DATË 11.12.2008 “PËR LOJËRAT E FATIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6
Mbrojtja nga lojërat e fatit

Organizatorit të lojërave të fatit i ndalohet të punësojë dhe të lejojë të futen apo të luajnë në mjediset e lojërave të fatit persona nën moshën 18 vjeç.

Organizatori merr masa të ndalojë të luajë në mjediset e lojërave të fatit një person mbi 18 vjeç, për të cilin ka një kërkesë me shkrim, të paktën prej njërit nga familjarët, i cili, për shkak të gjendjes ekonomike familjare, kërkon moslejimin e këtij personi të hyjë në mjediset e lojërave të fatit.

Kërkesa duhet të jetë e noterizuar dhe depozitohet pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Kërkesës i bashkëngjitet një kopje e certifikatës së gjendjes familjare.

Pas marrjes së këtij denoncimi, NJMLF-ja njofton të gjitha subjektet, që operojnë në fushën e lojërave të fatit, për moslejimin e këtij personi të luajë në këto mjedise. Njoftimi publikohet edhe në faqen zyrtare të njesisë.”.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoriteti i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për dhënien e licencave i jep licencë për kazino dhe për lotari kombëtare aplikantit, që shpallet fitues në një procedurë gare, e cila zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e që plotëson kriteret ligjore të përcaktuara për marrjen e licencës kazino.”.

2. Në pikën 4, në fund të shkronjës “ç” shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në rastin e mbylljes së sallës, organizatori duhet të depozitojë, përveç kërkesës pranë NJMLF-së, edhe një vërtetim nga organet tatimore se organizatori (shoqëria) nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore.”.

Neni 3

Në nenin 12, pika 3 shfuqizohet.

Neni 4

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Financimi dhe buxheti i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit financohet nga të ardhurat e veta. Burimet e financimit janë të ardhurat e siguruar nga pagesat, që bëjnë shoqëritë e miratuara e të licencuara në fushën e lojërave të fatit, sipas nenit 12 të këtij ligji, si dhe të ardhurat e siguruar nga vjelja e gjobave, sipas nenit 49 të këtij ligji.

Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, jo më vonë se tre muaj para fillimit të çdo viti financiar, i paraqet Ministrit të Financave planin e të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin e ardhshëm, të shoqëruar edhe me realizimin e pritshëm të këtyre treguesve për vitin në vazhdim. Ministri i Financave miraton planin e shpenzimeve të parashikuara për vitin e ardhshëm.

Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

Të gjitha të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit kalojnë në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 5

Në nenin 23, shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) të paraqesë rregulloren e lojës, e cila, detyrimisht, duhet të përmbajë:

- i) emrin dhe selinë e organizuesit;
- ii) emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës së fatit;
- iii) kushtet për pjesëmarrje në lojën e fatit;
- iv) vendin ku organizohet loja;
- v) afatin e fundit për pjesëmarrje në lojë;
- vi) fondin e fitimit dhe llojin e fitimeve;
- vii) mënyrën, procedurën e mbikëqyrjes dhe të tërheqjes, përkatësisht, mënyrën e verifikimit të fitimeve;
- viii) mënyrën e publikimit të shumave të fondit fitues dhe të rezultateve të lojës;
- ix) mënyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve monetare;
- x) mënyrën e njohjes me rregullat të pjesëmarrësit në lojë;
- xi) procedurat, që përdoren në rastin e revokimit të tërheqjes;
- xii) çdo dokument shtesë, të kërkuar nga NJMLF-ja.”.

Neni 6

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Lejimi i luajtjes së lojërave në kazino

1. Autoriteti i autorizuar ka të drejtë të japë licencën për kazino për një periudhë 10-vjeçare.

a) Licenca i jepet aplikantit, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

b) Tarifat për marrjen e licencës për kazino janë si më poshtë:

- i) për licencë në zonën e Tiranës, 1 000 000 000 (një miliard) lekë;
- ii) për licencë në zonën e Durrësit, 600 000 000 (gjashtëqind milionë) lekë;
- iii) për licencë në zonat e tjera të Republikës së Shqipërisë, 300 000 000 (treqind milionë)

lekë.

2. Organizatori i pajisur me licencë nuk mund të hapë më shumë se një kazino.”.

Neni 7

Neni 33 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34

Procedura e hapjes së garës për licencën për kazino

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, që kërkojnë të pajisen me licencë për kazino duhet të aplikojnë pranë autoritetit të autorizuar.

2. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret, strukturën e komisionit të shqyrtimit të aplikimit, dokumentacionin dhe kushtet, që duhet të plotësojë aplikanti për t’u pajisur me licencë për kazino, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence.

3. Në përcaktimin e kriterëve duhet të mbahen parasysh, të paktën:

a) burimi i kapitalit, që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinosë;
b) përvoja e subjektit në fushën e lojërave të fatit;
c) kapacitetet e duhura financiare, administruese, organizative dhe besueshmëria e aplikantit për t’u angazhuar me sukses në projekte të tilla;

ç) garancia pasurore, e cila do të paraqitet së bashku me aplikimin dhe me kushtet e sekuestrimit të kësaj garancie;

d) kufizimet për ndryshimet e pronësisë së aksioneve për të licencuarit.

4. Informacioni, që shoqëron kërkesën për licencë për kazino, përfshin edhe:

a) të dhëna personale për aksionarët kryesorë të shoqërisë, që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve dhe pronarët kryesorë përfitues;

b) të dhëna për organet drejtuese të aplikantit;

c) të dhëna financiare për kryerjen e biznesit të aksionarëve të aplikantit, për 3 vitet e fundit, përpara paraqitjes së kërkesës;

ç) vetëdeklarimin e aksionarëve të shoqërisë dhe të përfaqësuesit në organet drejtuese të saj se nuk janë në ndjekje penale;

d) çdo informacion tjetër, të cilin autoriteti i autorizuar e gjykon të nevojshëm t’ia kërkojë aplikantit për fushën e veprimtarisë që do të ushtrohet.

5. Kundërshtimi, refuzimi apo dhe devijimet e bëra nga aplikanti, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, përbëjnë shkak ligjor për refuzimin e kërkesës dhe për zbatimin e sanksioneve të tjera nga autoriteti i autorizuar nga ligji.”.

Neni 9

Neni 35 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Njoftimi i pranimi ose refuzimit të aplikimit

1. Autoriteti i autorizuar njofton, me shkrim, aplikuesin për pranimin ose refuzimin e aplikimit, brenda afateve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Në rast refuzimi, aplikuesi ka të drejtë, brenda 30 ditëve nga data që ka marrë njoftim apo nga data kur ai duhej të kishte marrë njoftim, të bëjë ankesë tek titullari i autoritetit të autorizuar, i cili duhet të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankimit.

3. Vendimi i autoritetit të autorizuar është përfundimtar nga ana administrative.

4. Në rast të pranimi të aplikimit, autoriteti i autorizuar kërkon nga aplikuesi të paguajë tarifën e përcaktuar në nenin 32 të këtij ligji, si dhe fondin e garancisë të lëshuar nga një bankë, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të Ministrisë së Financave, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga kjo e fundit, si garanci për fituesit e lojërave të fatit. Pagesa e tarifës dhe ajo e fondit të garancisë së fituesit bëhen brenda afatit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Në rast se aplikimi i pranuar është bërë nga një person juridik i huaj, ky i fundit duhet që, së bashku me pagesat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, të paraqesë dhe dokumentacionin, i cili vërteton krijimin e një shoqërie të personit juridik shqiptar, aksionet e së cilës do të zotërohen në masën 100 për qind nga aplikuesi. Në këtë rast, licenca i jepet personit juridik shqiptar. Këshilli i Ministrave cakton kushte për marrëdhënien juridike, që duhet të mbajë aplikuesi dhe shoqëria e krijuar prej tij, sipas kësaj pike, me autoritetin e autorizuar.”.

Neni 11

Në nenin 39 paragrafi i parë, fjalët “me propozimin e Ministrit të Financave” shfuqizohen.

Neni 12

Në nenin 44 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 5.2 ndryshohet si më poshtë:

“5.2. Për bastet sportive:

Organizatori i basteve sportive paguan tatim për lojërat e fatit 5 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave, por jo më pak se:

a) për 1 deri në 99 NIPTE, 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari;

b) për 100 deri në 149 NIPTE, 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari;

c) mbi 150 NIPTE, 14 000 000 (katërbëdhjetë milionë) lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari.

Organizatori duhet t’u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë.

Përveç pagesave të shoqërisë, për çdo pikë basti, duhet të kryhen pagesat në tarifa fikse mujore si më poshtë:

a) për rrethet e kategorisë së parë, 40 000 (dyzet mijë) lekë;

b) për rrethet e kategorisë së dytë, 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

c) për rrethet e kategorisë së tretë, 20 000 (njëzet mijë) lekë.

Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i kalojnë në favor 0,2 për qind e shumave të grumbulluara, në përputhje me këtë nen, për zhvillimin e sporteve.”.

2. Pika 5.3 ndryshohet si më poshtë:

“5.3. Për kazino elektronike:

Organizatori i lojërave për kazino elektronike paguan tatim mujor mbi lojërat e fatit 4 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, për por jo më pak se:

a) për rrethet e kategorisë së parë, 400 000 (katërqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;

b) për rrethet e kategorisë së dytë, 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;

c) për rrethet e kategorisë së tretë, 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 40 000 (dyzet mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;

ç) për çdo makinë elektronike me më shumë se një pozicion (ruletë) organizatori paguan një kuotë fikse mujore prej 1 000 000 (një milion) lekësh dhe 300 000 lekësh në muaj për çdo pozicion loje, pavarësisht nga rrethi ku ushtron veprimtarinë.

Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë.”.

Neni 13

Në nenin 41, shkronja “c” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“c) shoqëria të ketë kapital themeltar jo më të vogël se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për bingo tradicionale dhe jo më të vogël se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për bingo televizive.”.

Neni 14

Në nenin 45 “Detyrimi tatimor për kazinotë” bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c” zëvendësohen me shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” si më poshtë:

a) për tryezat me më shumë se një pozicion (ruletë), një taksë mujore në masën 12 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 300 000 (treqind mijë) lekë në muaj për çdo pozicion;

b) për çdo tryezë të lojërave (me letra dhe/ose me zare), një taksë mujore në masën 12 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

c) për lojërat elektronike dhe për videlotarinë, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore në masën 4 për qind për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për çdo kompjuter elektronik;

ç) për makinat slot me fitim në çast, një taksë mujore në masën 4 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për çdo kompjuter elektronik.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë.”.

Neni 15

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1:

a) paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, në rastet kur:”;

b) pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:

“i) organizatori i lojërave të fatit nuk respekton ndalimet e parashikuara në paragrafin e parë dhe në atë të dytë të nenit 6 të këtij ligji.”.

2. Shkronja “ç” e pikës 5 ndryshohet si më poshtë:

“ç) për kazino elektronike 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo makinë;”.

Neni 16

Në nenin 49, pas paragrafit të dytë të pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“50 për qind e të ardhurave nga gjobat përdoren nga NJMLF-ja për investime, si për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës dhe 50 për qind përdoren në formën e shpërblimit mbi pagë për vështirësi në punë, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.”.

Neni 17

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 59

Pajisja me armë e inspektorëve
Inspektorët e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit kanë të drejtë të pajisen me armë zjarri.

Miratimi i lejes jepet nga Ministria e Brendshme, vetëm pas autorizimit të lëshuar nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, për përcaktimin e inspektorëve dhe të llojit të armatimit.”.

Neni 18

Në nenin 61 “Dispozita kalimtare”, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për të gjitha subjektet e licencuara deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji, në kategoritë e basteve sportive apo bingo, afati i vlefshmërisë është afati i përcaktuar në çastin e lëshimit të tyre.

Organi tatimor kryen rimbursimin e shumave të dëmshpërblimit për të gjitha shoqëritë e lojërave të fatit, të cilave u është revokuar me ligj licenca. Kriteret, mënyra, masa dhe forma e dëmshpërblimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Mënyra e llogaritjes së detyrimeve tatimore, që do të paguhet nga shoqëritë e përmendura në paragrafin e parë të kësaj pike, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6375, datë 7.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 201, datë 17.12.2009

PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti i ligjit**

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi i regjistrimit

Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore bëhet me qëllim që:

- a) të sigurojë informacion të përgjithshëm dhe të hollësishëm për të gjitha njësitë ekonomike bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) të ofrojë të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor;
- c) të krijojë regjistrin e fermave bujqësore.

Neni 3
Fusha e zbatimit të regjistrimit

1. Regjistrimi përfshin të gjitha njësitë ekonomike, që kanë në përdorim tokë bujqësore apo që mbarështojnë bagëti, ose që prodhojnë produkte bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi përfshin njësitë ekonomike bujqësore, që tregtojnë, njësitë ekonomike, që mbulojnë vetëm nevojat e tyre familjare, si edhe të gjitha njësitë, që ushtrojnë veprimtari tregtare me kohë të pjesshme.

2. Pyjet dhe kullotat në pronësi publike nuk përfshihen në fushën e zbatimit të këtij regjistrimi.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Regjistrim” është regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore.
- b) “Njësi ekonomike bujqësore” është një njësi e vetme, si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe ekonomike, e cila drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të renditura në aneksin I, që i bashkëlidhet këtij ligji.
- c) “Drejtues i njësive ekonomike bujqësore” është personi fizik apo juridik, i cili, personalisht, si kultivues dhe mbarështues i drejtëpërdrejtë ose me vartës e bashkëpjesëmarrës apo me persona dhe subjekte të tjera merr përsipër zhvillimin e një njësie ekonomike bujqësore.
- ç) “Vendndodhje” është vendndodhja administrative e selisë së njësisë ekonomike bujqësore.

Neni 5
Të dhënat e mbledhura

Në të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit përfshihen:

- a) vendndodhja e njësive ekonomike bujqësore;
- b) organizimi dhe struktura e tyre, statusi dhe forma ligjore e pronësisë;
- c) gjinia, mosha dhe vëllimi i punës se kryer nga anëtarët e familjeve dhe persona, që nuk janë anëtarë të këtyre familjeve;
- ç) të dhëna të hollësishme për sipërfaqet bujqësore, pyjet e kullotat në pronësi private, numrin e rrënjëve dhe numrin e bagëtive;
- d) makineritë dhe pajisjet e fermave;
- dh) karakteristikat e ndërtesave, që përdoren për qëllime bujqësore;
- e) të dhëna për ujitjen;
- ë) karakteristika të tjera të njësisë ekonomike, të cilat përcaktohen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 6

Detyrimi për të raportuar

Drejtuesit e njësive ekonomike bujqësore, objekt i regjistrimit të përgjithshëm, janë të detyruar që, në çastin e regjistrimit, të japin informacion të plotë, korrekt e të vërtetë, sipas pyetësorëve përkatës, të hartuar nga Instituti i Statistikave.

Neni 7

Organet zbatuese dhe monitoruese

Regjistrimi organizohet dhe realizohet nga Instituti i Statistikave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit, me mbështetjen e komisioneve të regjistrimit në qarqe, komuna dhe bashki.

Neni 8

Data e regjistrimit dhe periudha e mbledhjes së të dhënave

Këshilli i Ministrave, me propozim të Komisionit Qendror të Regjistrimit, përcakton me vendim datën e fillimit dhe të mbarimit të regjistrimit dhe afatin e publikimit të të dhënave statistikore.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave personale dhe sekreti profesional

1. Organet e përcaktuara në kreun II të këtij ligji, gjatë dhe pas përfundimit të procesit të regjistrimit, garantojnë:

a) ruajtjen e plotë të fshehtësisë profesionale të të dhënave të regjistrimit, në përputhje me ligjet nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikatz zyrtare në Republikën e Shqipërisë” dhe nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë”;

b) trajtimin si të dhëna anonime të të gjitha të dhënave personale të individëve, gjatë dhe pas përfundimit të procesit të regjistrimit;

c) publikimin e çdo rezultati statistikor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Asnjë autoritet publik, në asnjë rrethanë nuk mund t’i shmanget këtij detyrimi.

Neni 10

Rezultatet e regjistrimit

1. INSTAT-i paraqet dhe boton rezultatet e përkohshme dhe përfundimtare të regjistrimit në baza shkencore dhe profesionale. Rezultatet statistikore, në nivel vendi ose njësie të qeverisjes vendore, duhet të paraqiten në një formë, e cila përjashton çdo mundësi identifikimi të të dhënave personale.

2. Të dhënat e mbledhura në kuadër të këtij programi regjistrimi, i dërgohen edhe EUROSTAT-it, i cili nuk mund t’i transferojë pa autorizimin e INSTAT-it.

KREU II

PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË DHE MARRËDHËNIET E ORGANEVE TË NGARKUARA PËR REGJISTRIM

Neni 11

Komisioni Qendror i Regjistrimit

1. Komisioni Qendror i Regjistrimit është organi më i lartë që mbikëqyr dhe drejton organizimin dhe realizimin e regjistrimit.

2. Mënyra e organizimit, funksionimit, përbërjes dhe kryesimi i Komisionit Qendror të Regjistrimit përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Regjistrimit

Komisioni Qendror i Regjistrimit ka këto përgjegjësi:

- a) harton dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të tij;
- b) mbikëqyr dhe monitoron përgatitjen e zbatimit të regjistrimit;
- c) lehtëson dhe garanton bashkërendimin e punës për regjistrim, ndërmjet ministrave, institucioneve qendrore dhe palëve të tjera, të përfshira në këtë proces;
- ç) përcakton përbërjen dhe kryesimin e komisioneve të regjistrimit në qarqe dhe ia propozon për miratim Këshillit të Ministrave;
- d) miraton përbërjen dhe detyrat e komisioneve të regjistrimit në njësitë vendore, sipas përcaktimeve të bëra nga komisionet e regjistrimit në qarqe dhe ia propozon për miratim Këshillit të Ministrave;
- dh) miraton përmbajtjen e akteve nënligjore, të hartuara nga INSTAT-i dhe ia propozon për miratim Këshillit të Ministrave;
- e) kryen detyra të tjera, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 13

Komisionet e regjistrimit në qarqe

Komisionet e regjistrimit në qarqe ushtrojnë këto detyra:

- a) janë përgjegjëse për organizimin dhe realizimin e të gjithë procesit të regjistrimit, në juridiksionin e qarkut;
- b) miratojnë, me propozimin e këshillit të komunës/bashkisë, personelin (numrin dhe kualifikimin) e komisioneve të regjistrimit në bashki/komuna;
- c) trajnojnë dhe pajisin me bazën e duhur materiale personelin e regjistrimit, si dhe hartojnë programet e punës, në kuadër të këtij regjistrimi, për bashkitë dhe komunat.

Neni 14

Komisionet e regjistrimit në bashki dhe komuna

Komisionet e regjistrimit në bashki dhe komuna kryesohen nga kryetari i bashkisë ose komunës dhe ushtrojnë këto detyra:

- a) organizojnë, kryejnë dhe zbatojnë të gjithë kuadrin ligjor dhe udhëzimet e niveleve më të larta për regjistrimin në juridiksionin e tyre;
- b) përzgjedhin anketuesit në përputhje me nenin 19 të këtij ligji dhe me kriteret e kualifikimit të miratuara nga Këshilli i Ministrave me propozimin e INSTAT-it;
- c) organizojnë trajnimin e anketuesve;
- ç) marrin në dorëzim, administrojnë e dërgojnë materialet e regjistrimit në qark;
- d) organizojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e regjistrimit drejtpërdrejt në terren.

Neni 15

Instituti i Statistikave

INSTAT-i ka këto përgjegjësi:

- a) harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen e zbatimit të regjistrimit në baza profesionale dhe shkencore;
- b) administron burimet njerëzore dhe financiare, të caktuara për regjistrim dhe i raporton Komisionit Qendror të Regjistrimit e donatorëve ndërkombëtarë për mënyrën e përdorimit të këtyre burimeve;

c) harton termat e referencës, profilet e punës dhe udhëzimet e trajnimit, që duhen zbatuar nga komisionet e regjistrimit në qarqe dhe komisionet e regjistrimit në bashki dhe komuna, për përzgjedhjen e trajnimit të personelit të regjistrimit;

ç) u propozon autoriteteve dhe organeve qeveritare përkatëse hapat që duhen ndërmarrë për regjistrimin, si dhe zhvillon fushatën për informimin e publikut;

d) i paraqet propozime Komisionit Qendror të Regjistrimit për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit;

dh) deiton metodikisht punën për realizimin e regjistrimit në të gjitha fazat, në bashkëpunim me institucionet dhe organet e regjistrimit, në nivelin e njësive të qeverisjes vendore;

e) paraqet e boton rezultatet paraprake dhe përfundimtare të regjistrimit;

ë) harton akte nënligjore, në zbatim të këtij ligji dhe i paraqet ato për miratim në Komisionin Qendror të Regjistrimit;

f) i siguron Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për kryerjen me efikasitet të veprimtarive statistikore pas realizimit të regjistrimit;

g) përcakton masa që personeli i angazhuar në regjistrim dhe në plotësimin e pyetësorëve, i cili ka njohuri për të dhëna personale, t'i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional të të dhënave, në përputhje me ligjet nr.9180, datë 5.2.2004 "Për statistikën zyrtare në Republikën Shqipërisë" dhe nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë" gjatë dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, si dhe masa për parandalimin e përpunimit të paautorizuar të të dhënave të mbledhura në kuadër të këtij regjistrimi.

Neni 16

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i jep në kohë INSTAT-it listën e pronarëve të tokës, sipërfaqen në pronësi dhe adresat e vendndodhjes së tyre.

Neni 17

Institucionet e tjera të përfshira në regjistrim

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, ndërmjet institucioneve të tjera, në bashkëpunim me INSTAT-in, vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Regjistrimit të dhëna dhe burime për lehtësimin e veprimtarive të regjistrimit. Forma dhe mënyra e këtij bashkëpunimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

Neni 18

Bërja publike e procedurave të regjistrimit

1. Qëllimet dhe procedurat e regjistrimit e detyrimet ligjore lidhur me të bëhen publike nëpërmjet shkëmbimeve shkresore zyrtare, medias dhe një fushate të gjerë njoftimesh, të drejtuar nga INSTAT-i.

2. Bërja publike e procedurave fillon të paktën katër javë para fillimit të regjistrimit.

Neni 19

Personeli i regjistrimit

1. Në përbërje të personelit të regjistrimit janë:

- a) statisticienët, specialistët e fushës dhe personeli i teknologjisë së informacionit;
- b) personeli i administratës;
- c) mbikëqyrësit;
- ç) kontrollorët;
- d) anketuesit;
- dh) operatorët.

2. Kriteret për përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e personelit të regjistrimit, si dhe detyrat e përgjegjësitë e personelit të regjistrimit miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të INSTAT-it.

3. Procesi i rekrutimit të personelit të regjistrimit bëhet si më poshtë:

- a) rekrutimi i anketuesve bëhet nga komisionet e regjistrimit në komuna/bashki;
- b) rekrutimi i kontrollorëve bëhet nga komisionet e regjistrimit të qarqeve, me rekomandimin e komisioneve të regjistrimit në komuna/bashki;
- c) rekrutimi i mbikëqyrësve bëhet nga komisionet e regjistrimit të qarqeve;
- ç) rekrutimi i operatorëve, personelit të administratës dhe personelit tjetër bëhet nga INSTAT-i.

Neni 20

Ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme

1. Gjatë periudhës prej 6 javësh para fillimit të regjistrimit dhe gjatë të gjithë kohëzgjatjes së mbledhjes së të dhënave të regjistrimit të gjithë individëve dhe organizatave, me përjashtim të INSTAT-it, u ndalohej të grumbullojnë të dhëna nga njësitë ekonomike bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Të gjitha subjektet, të cilave, gjatë periudhës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, u nevojitet mbledhja e të dhënave, mund ta zhvillojnë këtë veprimtari vetëm me autorizim të veçantë, lëshuar nga Komisioni Qendror i Regjistrimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 21

Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Moskryerja e detyrave, pengimi i procesit, vonesa në afate, si dhe çdo formë tjetër veprimtarie bërë me ose pa dashje nga personat fizikë e juridikë të përfshirë në regjistrim, përbën kundërvajtje administrative dhe çon në vënien para përgjegjësisë të tyre. Në rastin e kundërvajtjes administrative të shkaktuar nga personat juridikë publikë ose privatë, përgjegjësia i takon drejtuesve administrativë të tyre.

2. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) Çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenin 9 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 40 000 lekë.

b) Çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenin 20 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

3. Mospërmblidhja e detyrimit të parashikuar në nenin 6 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 5 000 lekë. Për rastet e përsëritura, gjobat janë nga 5 000 deri në 25 000 lekë për çdo shkelje.

4. Gjobat për kundërvajtjet administrative, siç parashikohet më sipër, vendosen nga kryetari i komisionit të regjistrimit në qark në rast se kundërvajtja ndodh në nivel komune/bashkie dhe nga Kryetari i Komisionit Qendror të Regjistrimit në rast se kundërvajtja bëhet në nivel qarku, me propozim të INSTAT-it.

Neni 22

Ankimi

1. Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe atij të qarkut mund të bëhet ankimi pranë gjykatës përkatëse brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, 11, 12, 17 e 19 të tij.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6376, datë 7.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

ANEKSI 1

LISTA E AKTIVITETEVE BUJQËSORE QË I REFEROHEN DEFINICIONIT TË NJËSISË EKONOMIKE BUJQËSORE

Aktivitetet e mëposhtme (të cilat mund të jenë aktivitete janë bazuar në Klasifikimin Statistikor European të Aktiviteteve Ekonomike (Nace rev. 2), për prodhimin e kafshëve dhe të bimëve, gjueti dhe aktivitete të shërbimeve të lidhura me to dhe janë përdorur për përcaktimin e njësive ekonomike bujqësore.

Përshkrimi i aktivitetit	NACE Rev. 2	Shënime shtesë mbi aktivitetet e përfshira ose të përjashtuara kur përshkruhet aktiviteti bujqësor
Kultivimi i bimëve jo-shumëvjeçare	01.1	
Kultivimi i bimëve shumëvjeçare	01.2	Njësitë bujqësore të cilat prodhojnë verë ose vaj ulliri nga rrushi ose ulliri i prodhuar vetë janë përfshirë në fushën e mbulimit të këtij ligji.
Shtimi i bimëve	01.3	
Prodhimi i kafshëve	01.4	Të gjitha aktivitetet të klasifikuara nën 01.49 të NACE Rev.2 (rritja e kafshëve të tjera) do të përjashtohen nga fusha e këtij ligji me përjashtim: (i) rritja dhe seleksionimi i strucit, emus dhe lepujve; (ii) mbajtja e bletëve dhe prodhimi i mjaltit dhe dyllit të bletëve.

Bujqësia e përzier	01.5	
Aktivitetet ndihmëse në bujqësi dhe aktivitete të pas korrjes	01.6	Në përgjithësi të gjitha njësitet që kryejnë aktivitete nën 01.6 të NACE rev. 2 janë përjashtuar nga fusha e këtij ligji nëse ato janë ndërmarrë në mënyrë ekskluzive. Megjithatë, njësitet që vetëm mirëmbajnë tokën bujqësore në kushte të mira bujqësore dhe mjedisore (nën 01.61 të NACE Rev. 2) janë përfshirë në fushën e këtij ligji.

ANEKS II

PRAGJET PËR VROJTIMIN E STRUKTURËS SË FERMËS DHE VROJTIMIN MBI METODAT E PRODHIMIT

Karakteristikat		Pragu (Threshold)
Sipërfaqe e përdorur bujqësore	Tokë e punueshme, kopshte, livadhe shumëvjeçare, bimë shumëvjeçare	5 ha
Bimë shumëvjeçare	Plantacione me fruta, mana, agrume dhe ullinj, vreshta dhe fidanishte.	1 ha
Të tjera prodhime intensive	Perime të freskëta, pjepër (melons) dhe luleshtrydhe, të cilat janë kultivuar jashtë ose në mbulesë mbrojtëse të ulët	0.5 ha
	Duhan	0.5 ha
	Hummulus lupulus (hops)	0.5 ha
	Pambuk	0.5 ha
Bimët në serra ose mbulesë tjetër mbrojtëse	Perime të freskëta, pjepër dhe luleshtrydhe	0.1 ha
	Lule dhe bimë të tjera ornamentale (përjashtohen fidanishtet)	0.1 ha
Gjedhi	Të gjitha	10 krerë
Derrat	Të gjitha	50 krerë
	Dosat për mbarështrim	10 krerë
Të imtat	Të gjitha	20 krerë
Të dhirtat	Të gjitha	20 krerë
Shpendët	Të gjitha	1 000 krerë

ANEKSI III	
LISTA E KARAKTERISTIKAVE TË VROJTIMIT TË STRUKTURËS SË FERMËS	
KARAKTERISTIKAT	NJESITË/ KATEGORITË
I. Karakteristika të përgjithshme	
- Lokalizimi i njësisë	
-- Gjerësi (brenda harkut prej 5 minutash ose më pak)	Gradë: minuta
-- Gjatësi (brenda harkut prej 5 minutash ose më pak)	Gradë: minuta
- Forma juridike e njësisë bujqësore	
-- Forma juridike dhe ekonomike e njësisë e përmbledhur sipas:	
--- një person fizik, i cili është drejtues i vetëm, ku njësia është e pavarur	Po/Jo
--- një ose më shumë persona fizik i cili është/janë partner, ku njësia është grupim njësish	Po/Jo
--- person ligjor	Po / Jo
-Tipi i zotërimit (në lidhje me drejtuesin) dhe sistemi i kultivimit	
-- Sipërfaqe bujqësore e përdorur:	
-- Bujqësia organike	
II. Toka	
- Tokë e punueshme	
-- Drithëra për prodhim kokërr (përfshi dhe farën)	ha
-- Bishtajoret dhe bimët proteinike për prodhimin e kokrrave (përfshihen dhe përzierit e drithërave me farat bishtajoret)	ha
-- Patatet (përfshihen patatja e hershme dhe fara e patates)	ha
-- Panxharsheqeri (përfshihet fara)	ha
-- Foragjere rrënjore dhe lakra (përfshihet fara)	ha
-- Bimët industriale	ha
-- Perime te freskëta, luleshtrydhe dhe pjepër:	ha
-- Në fushë të hapur	ha

-- Nën xham ose mbulesë tjetër mbrojtëse (të përshkueshme)	ha
	ha
-- Lule dhe bimë ornamentale (përfshihen fidanishtet)	ha
	ha
-- Bimë që kositen për masë të gjelbër	ha
	ha
-- Farëra dhe fidanë që kultivohen në tokë të punueshme	ha
	ha
-- Të tjera bimë që kultivohen në toka të punueshme	ha
	ha
-- Tokë djerr	ha
	ha
- Kopshtet	ha
	ha
- Livadhe permanente (përhershme)	ha
-- Livadhe dhe kullota , përjashtojnë kullotjen në vathe (në mal gjatë periudhës së verës)	ha
-- Kullotje në vathë	ha
	ha
-- Livadhe permanente që nuk përdoren më për qëllim prodhimi e përshtatshme për pagesën e subvencioneve	ha
	ha
- Bimë shumëvjeçare	ha
	ha
-- Plantacionet e frutave	ha
	ha
-- Plantacione agrumesh	ha
	ha
-- Plantacione ullinjsh	ha
--- Ullinj që prodhohen për tavolinë	ha
	ha
--- Ullinj që prodhohen për prodhimin e vajit të ullirit	ha
	ha
-- Vreshta, prej të cilave prodhohet:	ha
	ha
--- Rrush tavoline	ha
	ha
---- Rrush për verë	ha
	ha
-- Fidanishte	ha
-- Të tjera bimë shumëvjeçare	ha

--- prej të cilave pemët e Krishtlindjes	ha
	ha
- Të tjera toka	ha
	ha
-- Tokë bujqësore e papërdorur	ha
	ha
-- Sipërfaqe drusore	ha
	ha
-- Të tjera toka (tokë e okupuar nga ndërtesat, shtegje, oborre, pellgje, tokë jopjellore, shkëmbore etj)	ha
	ha
-- Sipërfaqe e ujitur	ha
III. Blegtoria	
- Njëthundrakët	Krerë
- Gjedhi	
- Të imta dhe të dhirta	
- Derrat	
- Shpendët	
- Bletët	Koshere
- Blegtori e papërmendur më sipër	Po/Jo
IV. Makineritë	
- Që i përkasin në mënyrë ekskluzive njësisë	
-- Traktorë me katër rrota, mjete transportuese	Numër
-- Kultivator, makina pluguese, plug rotativ dhe transportues motorik,	Numër
-- Kositëse e kombinuar	Numër
-- Të tjera kositëse plotësisht të mekanizuara	Numër
- Makineri të përdorura për disa njësi	
-- Traktorë me katër rrota, mjete transportuese	Po/Jo
-- Kultivator, makina pluguese, plug rotativ dhe transportues motorik,	Po/Jo

-- Kositëse e kombinuar	Po/Jo
-- Të tjera kositëse plotësisht të mekanizuara	Po/Jo
V. Forcat e punës	
V. (i) Puna e fermës në njësi	
- Drejtuesi	
-- Gjinia	Mashkull/Femër
-- Mosha	Grup mosha(2)
-- Puna e fermës në njësi (e ndarë nga punët e shtëpisë)	AWU % band 1(3)
- Menaxheri	
-- Gjinia	Mashkull/Femër
-- Mosha	Grup mosha
-- Puna e fermës në njësi (e ndarë nga punët e shtëpisë)	AWU % band 2(4)
- Trajnimi i menaxherit	
-- Trajnimi bujqësor i menaxherit	Kodet e trajnimit(5)
-- Trajnimi profesional i ndërmarrë nga menaxheri gjatë 12 muajve të fundit	Po/Jo
- Vetëm anëtarët e familjes së drejtuesit që kryejnë punë në fermë për njësinë; meshkuj	
-- Puna e fermës në njësi (e ndarë nga punët e shtëpisë)	AWU % band 2
- Vetëm anëtarët e familjes së drejtuesit që kryejnë punë në fermë për njësinë; femra	
-- Puna e fermës në njësi (e ndarë nga punët e shtëpisë)	AWU % band 2
- Puna e jo-familjarëve të punësuar rregullisht, meshkuj	
-- Puna e fermës në njësi (e ndarë nga punët e shtëpisë)	AWU % band 2

- Puna e jo-familjarëve të punësuar rregullisht, femër	
-- Puna e fermës në njësi (e ndarë nga punët e shtëpisë)	AWU % band 2
- Puna e jo-familjareve të punësuar jo-rregullisht, meshkuj dhe femra	
- Numri total i ditëve ekuivalente me kohën e plotë të punës në fermë gjatë 12 muajve që paraprijnë ditën e vërtetimit, që nuk përfshihen në kategoritë e mëparshme dhe që gjatë të cilave, puna e ndërmarrë në njësi është realizuar nga persona të papunësuar direkt nga njësi (p.sh. të punësuar me kontratë).	Ditë pune me kohë të plotë (full-time working days)
V. (ii) Të tjera aktivitete fitimprurëse (punë jo-bujqësore në njësi dhe punë jashtë njësisë)	
- Të tjera aktivitete fitimprurëse të drejtuesit i cili është gjithashtu dhe Menaxher	
-- Si aktivitet kryesor i tij/ saj	Po/Jo
-- Si aktivitet ndihmës i tij/saj	Po/Jo
-- Nëse janë kryer aktivitete të tjera fitimprurëse	Po/Jo
- Të tjera aktivitete fitimprurëse të bashkëshortit/tes të drejtuesit	Po/Jo
Të vetëm	
- Si aktivitet kryesor i tij/ saj	Po/Jo
-- Si aktivitet ndihmës i tij/saj	Po/Jo
-- Nëse janë kryer aktivitete të tjera fitimprurëse	Po/Jo
- Të tjera aktivitete fitimprurëse të anëtarëve të tjerë të familjes me pronar të Vetëm	
-- Si aktivitet kryesor i tij/ saj	Po/Jo
-- Si aktivitet ndihmës i tij/saj	Po/Jo
-- Nëse janë kryer aktivitete të tjera fitimprurëse	
- Forcat e punës jo-familjare, që shfrytëzohen direkt mbi një bazë të rregullt dhe janë përfshirë në aktivitete të tjera fitimprurëse, që janë lidhur direkt me Njësinë	

-- Si aktivitet kryesor i tij/ saj	Po/Jo
-- Si aktivitet ndihmës i tij/saj	Po/Jo
VI. Të tjera aktivitete fitimprurëse të njësisë që lidhen direkt me njësinë	
VI. (i) Lista e të tjera aktiviteteve fitimprurëse	
-Turizëm, akomodim dhe të tjera aktivitete të kohës së lirë	Po/Jo
- Transport me karroca (handcraft)	Po/Jo
-Përpunimi i produkteve të fermës	Po/Jo
- Puna me kontratë (duke përdorur mjetet e prodhimit të ndjesisë)	
-- Bujqësore (për njësitë e tjera)	Po/Jo
-- Jo-bujqësore	Po/Jo
- Të tjera	Po/Jo
VI. (ii) Rëndësia e aktiviteteve të tjera fitimprurëse që janë të lidhura direkt me njësinë	
VII. Mbështetja për zhvillimin rural	
- Njësitë që përfitojnë një nga masat e mëposhtme të zhvillimit rural gjatë tre viteve të fundit	
- Përdorimi i shërbimit këshillimor	Po/Jo
-- Modernizimi i njësive bujqësore	Po/Jo
-- Pagesat e lidhura me Direktivën e Rrjetit të Ujit	Po/Jo
-- Inkurajimi i aktiviteteve të turizmit	Po/Jo

LIGJ
Nr. 10 202, datë 17.12.2009

PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE
EKONOMIKE JOBUEJQËSORE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSFIME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobuejqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi i regjistrimit

Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike jobuejqësore bëhet me qëllim që:

- a) të sigurojë informacion të përgjithshëm dhe të hollësishëm për njësitë ekonomike jobuejqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) të ofrojë të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik;
- c) të përditësojë regjistrin e njësive ekonomike jobuejqësore dhe të krijojë regjistrin e njësive lokale ekonomike;
- ç) të përmirësojë cilësinë e treguesve identifikues dhe ekonomikë ekzistues, si edhe të bëjë përcaktimin e treguesve të rinj, veçanërisht të atyre ekonomikë;
- d) të identifikojë lidhjen që ekziston ndërmjet njësisë ligjore dhe njësisë ekonomike jobuejqësore.

Neni 3
Fusha e zbatimit të regjistrimit

Regjistrimi i përgjithshëm zbatohet për të gjitha njësitë ekonomike jobuejqësore, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Regjistrim” është regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike jobuejqësore.
- b) “Njësi ekonomike jobuejqësore” është njësi ligjore si person juridik, ekzistenca e së cilës njihet nga ligji, pavarësisht nga individët apo institucionet, që mund ta zotërojnë apo janë anëtarë në të dhe çdo person fizik i angazhuar në një veprimtari ekonomike në të drejtën e tij.

Neni 5

Të dhënat e mbledhura

1. Të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit përmbajnë:

a) NIPT-in, statusin, emrin e njësisë ekonomike, emrin dhe mbiemrin e drejtorit/administratorit, adresën dhe identifikuesit topografikë, formën ligjore, pronësinë, komunikimin (telefon, faks etj.);

b) veprimtarinë ekonomike që ushtron njësia, madhësinë sipas numrit të të punësuarve, xhiron dhe të dhëna të tjera ekonomike;

c) datën e krijimit, mbarimit, bashkimit, nënndarjen etj.;

ç) emrin e mbiemrin e pronarit/ve, gjininë, nënshtetësinë e pjesëmarrjen e tij/tyre në kapital.

2. Regjistrimi i njësive lokale ekonomike siguron të dhëna për vendndodhjen, veprimtarinë ekonomike, emrin e njësive lokale ekonomike, emrin e drejtorit/administratorit/ve, numrin e të punësuarve, xhiron, adresën, mënyrën e komunikimit (me telefon, fax etj.), si dhe datën e krijimit.

Neni 6

Detyrimi për të raportuar

Administratorët e njësive ekonomike, objekt i regjistrimit të përgjithshëm, janë të detyruar që, në çastin e regjistrimit, të japin informacion të plotë, korrekt e të vërtetë, sipas pyetësorëve përkatës, të hartuar nga Instituti i Statistikave.

Neni 7

Organet e zbatimit dhe të monitorimit

Regjistrimi organizohet dhe realizohet nga Instituti i Statistikave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit. Për realizimin e regjistrimit, INSTAT-i vendos pikat e kontaktit me punonjës të qeverisjes vendore në qarqe, bashki e komuna. Detyrat e tyre përcaktohen në aktet nënligjore, të hartuara në zbatim të nenit 20 të këtij ligji.

Neni 8

Data e regjistrimit dhe periudha e mbledhjes së të dhënave

Këshilli i Ministrave, me propozim të Komisionit Qendror të Regjistrimit, përcakton me vendim datën e fillimit dhe të mbarimit të regjistrimit dhe afatin e publikimit të të dhënave statistikore.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave personale dhe sekretit profesional

1. Organet e përcaktuara në kreun II të këtij ligji, gjatë dhe pas përfundimit të procesit të regjistrimit, garantojnë:

a) ruajtjen e plotë të fshehtësisë profesionale të të dhënave të regjistrimit, në përputhje me ligjet nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikatat zyrtare në Republikën e Shqipërisë” dhe nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

b) që publikimi i rezultateve statistikore të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Asnjë autoritet publik, në asnjë rrethanë, nuk mund t’i shmanget këtij detyrimi.

Neni 10
Rezultatet e regjistrimit

1. Rezultatet statistikore të regjistrimit kanë vlerën e dokumenteve zyrtare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

2. INSTAT-i paraqet e boton rezultatet e përkohshme dhe ato përfundimtare të regjistrimit në baza shkencore e profesionale. Rezultatet statistikore, në nivel vendi ose njësie të qeverisjes vendore, duhet të paraqiten në një formë, që të përjashtojë çdo mundësi identifikimi të të dhënave personale.

KREU II
PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË DHE MARRËDHËNIET
E ORGANEVE TË NGARKUARA PËR REGJISTRIM

Neni 11
Komisioni Qendror i Regjistrimit

1. Komisioni Qendror i Regjistrimit është organi më i lartë që mbikëqyr dhe drejton organizimin dhe realizimin e regjistrimit.

2. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe përbërja e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12
Përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Regjistrimit

Komisioni Qendror i Regjistrimit ka këto përgjegjësi:

- a) harton dhe miraton rregullat procedurale të funksionimit të tij;
- b) mbikëqyr dhe monitoron përgatitjen dhe zbatimin e regjistrimit;
- c) lehtëson dhe garanton bashkërendimin e punës për regjistrim ndërmjet ministrive, institucioneve qendrore dhe palëve të tjera, të përfshira në këtë proces;
- ç) miraton pikat e kontaktit, në nivelin e qeverisjes vendore, si edhe bën bashkërendimin e punës ndërmjet qeverisë qendrore, vendore e institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e regjistrimit, sipas përcaktimit të bërë në nenin 7 të këtij ligji;
- d) miraton përmbajtjen e akteve nënligjore, të hartuara nga INSTAT-i dhe ia propozon për miratim Këshillit të Ministrave;
- dh) kryen detyra të tjera, në përputhje me kërkesat e ligjit.

Neni 13
Instituti i Statistikave

INSTAT-i ka këto përgjegjësi:

- a) harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësozin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet e përshtatshme kompjuterike, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen e zbatimin e regjistrimit në baza profesionale dhe shkencore;
- b) administron burimet njerëzore dhe financiare, të caktuara për regjistrimin dhe i raporton Komisionit Qendror të Regjistrimit e donatorëve ndërkombëtarë për mënyrën e përdorimit të këtyre burimeve;
- c) u propozon autoriteteve dhe organeve qeveritare përkatëse hapat që duhen ndërmarrë për regjistrimin, si edhe zhvillon fushatën për informimin e publikut;
- ç) përgatit udhëzimet dhe pyetësorët për procesin e regjistrimit;
- d) propozon kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësojnë personat, që do të përzgjidhen si pika kontakti në organet e qeverisjes vendore (nenet 7 e 12 të këtij ligji);

dh) i paraqet propozime Komisionit Qendror të Regjistrimit për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit;

e) drejton metodikisht punën për realizimin e regjistrimit në të gjitha fazat, në bashkëpunim me institucionet dhe organet e regjistrimit, në nivelin e njërive të qeverisjes vendore;

ë) paraqet dhe boton rezultatet paraprake e përfundimtare të regjistrimit;

f) harton akte nënligjore, në përputhje me nenet 12 e 21 të këtij ligji dhe ia kalon për miratim Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Neni 14

Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i sigurojnë, në kohë, INSTAT-it bazën e të dhënave të nevojshme për njësitë ekonomike jobujqësore.

KREU III

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

Neni 15

Bërja publike e procedurave të regjistrimit

1. Qëllimet dhe procedurat e regjistrimit dhe detyrimet ligjore lidhur me të bëhen publike nëpërmjet shkëmbimeve shkresore zyrtare, medias dhe një fushate të gjerë njoftimesh, të drejtuara nga INSTAT-i.

2. Bërja publike e procedurave të regjistrimit duhet të fillojë të paktën katër javë para datës së fillimit të procesit të regjistrimit.

Neni 16

Personeli i regjistrimit

1. Në përbërje të personelit të regjistrimit janë:

a) statisticienët, specialistët e fushës dhe personeli i teknologjisë së informacionit;

b) personeli i administratës;

c) mbikëqyrësit;

ç) kontrollorët;

d) anketuesit;

dh) operatorët.

2. Kriteret për përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e personelit të regjistrimit, si dhe detyrat e përgjegjësitë e personelit të regjistrimit miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të INSTAT-it.

3. INSTAT-i miraton dhe punëson personelin e regjistrimit.

Neni 17

Ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme

1. Gjatë periudhës prej 6 javësh, para fillimit të regjistrimit dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së mbledhjes së të dhënave të regjistrimit, të gjithë individëve dhe organizatave, me përjashtim të INSTAT-it, u ndalohet të grumbullojnë të dhëna nga njësitë ekonomike jobujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Të gjitha subjektet, të cilave gjatë periudhës së përmendur u nevojitet mbledhja e të dhënave, mund ta zhvillojnë këtë veprimtari vetëm me autorizim të veçantë, lëshuar nga Komisioni Qendror i Regjistrimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 18
Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Moskryerja e detyrave, pengimi i procesit, vonesa në afate, si dhe çdo formë tjetër veprimtarie, e bërë me ose pa dashje nga personat fizikë e juridikë të përfshirë në regjistrim, përbën kundërvajtje administrative dhe çon në vënien para përgjegjësisë të tyre. Në rastin e kundërvajtjes administrative, të shkaktuar nga personat juridikë publikë ose privatë, përgjegjësia i takon drejtuesve administrativë të tyre.

2. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 40 000 lekë;

b) çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

3. Mospërmbushja e detyrimit të parashikuar në nenin 6 të këtij ligji dënohet me gjobë deri në 5 000 lekë. Për rastet e përsëritura, gjobat janë nga 5 000 lekë deri në 25 000 lekë për çdo shkelje.

4. Gjobat për kundërvajtjet administrative, siç parashikohen më sipër, vendosen nga Kryetari i Komisionit Qendror të Regjistrimit, me propozim të INSTAT-it.

Neni 19
Ankimi

1. Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Regjistrimit mund të bëhet ankim pranë gjykatës kompetente brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Procedurat për vënien dhe vjeljen e gjobave rregullohen nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 20
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, 11, 12 e 19 të tij.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6377, datë 7.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 14.1.2010
 Doli nga shtypi më 15.1.2010

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë